

VENDIM
Nr.584, datë 8.12.1999

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.213, DATË 28.3.1998, “PËR RRITJEN E PAGAVE TË FUNKSIONEVE TË LARTA SHTETËRORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 6, të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999, “Për kompetendat për caktimin e pagave të punës”, dhe të neneve 14, 23 dhe 29, të ligjit nr.8370, datë 9.7.1999, “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.213, datë 23.8.1998 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

Në lidhjen i “Renditja e funksioneve sipas klasifikimit” shtohen emërtimet e mëposhtme: në shkronjën B2 emërtimi “ambasador”; në shkronjën B3 emërtimi “ministër fuqplotë”; në shkronjën B4 emërtimi “ministër këshilltar”; në shkronjën B5 emërtimi “këshilltar”; në shkronjën C2 emërtimi “sekretar i parë” dhe në shkronjën C3 emërtimi “sekretar i dytë”.

-Në lidhjen II-5 “Nivelet e pagës për punonjësit e ministrave dhe institucioneve të tjera qendrore në pjesën “emërtime të tjera për punonjësit e Ministrisë së Punëve të Jashtme”, në pikën 2 shtohet emërtimi “sekretari i tretë” dhe në pikën 3 shtohet emërtimi “atashe”.

2.Paga për punonjësit me gradë diplomatike në shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë të mbështetet në kategorizimin e mëposhtëm:

a) Ambasador	Niveli B2	49 500 lekë
b) Ministër fuqplotë	Niveli B3	41 800 lekë
c) Ministër këshilltar	Niveli B4	34 100 lekë
ç) Këshilltar	Niveli B5	28 600 lekë
d) Sekretar i parë	Niveli C2	25 300 lekë
dh) Sekretar i dytë	Niveli C3	22 000 lekë
e) Sekretar i tretë	i barabartë me shef sektori në ministri	
ë) Atashe	I barabartë me specialistin e parë në ministri	

3.Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti vjetor i Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta